



Datë: 27.03.2025
Numër Protokolli: 2176/ 2025

A.nr.147/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, Atdhe Gashi- në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.147/2025 të datës 21.01.2025, të parashtruar nga ankuesi, M.K, kundër organit të punësimit/Komuna e Obiliqit, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa më numër A.nr.147/2025, e datës 21.01.2025, e parashtruar nga ankuesi M.K.

II. Anulohet në tersi konkursi me Nr. Reference: RN00015748 për pozitën Drejtori i Qendrës për Punë Sociale, në Komunën e Obiliqit, dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë.

III. Obligohet Kryetari i Komunës së Obiliqit, për zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të tij, ashtu sikurse është përcaktuar në piken II të dispozitivit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi, M.K(*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), më datë 21.01.2024 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 393/2025, të regjistruar nën shenjën A.nr.147/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00015784, për pozitën e punës të klasës së ulët drejtuese “*Drejtor i Qendrës për Punë Sociale*”, të shpallur më datë 07.11.2024 nga Komuna e Obiliqit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Obiliqit, ndërsa kjo e fundit më datë 21.01.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 1517/2025 të datës 07.03.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesi edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 381 të datës 20.01.2025, të parashtruar nga ankuesja, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Fletë aplikimin e ankueses; Dokument identifikimi i ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë të datës 11.02.2025; Kërkesën e datës 30.10.2024; Aprovimin e datës 05.11.2024; Konkursin me numër reference RN00015748 të datës 07.11.2024; Vendimin me numër 02/110/03-38405-24 të datës 16.12.2024; Akt emërimit Nr. II/22 të datës 15.08.2016; Akt emërimit Nr.II-44 të datës 14.09.2020; Akt emërimit II/06 të datës 10.04.2018; Akt emërimit II/36 të datës 07.05.2015; Akt emërimit II-1471 të datës 24.10.2022; Akt emërimit 02-110-03-21993-24 të datës 05.08.2024; Listën e kandidatëve të aprovuar dhe të refuzuar; Njoftimin e datës 11.12.2024; Vendimin e datës 11.12.2024; Testi me shkrim; Formularët e vlerësimit të esesë të datës 17.12.2024; Formularët e vlerësimit të eses të datës 23.12.2024; Renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 23.12.2024; Aplikacionin e ankuesit të datës 06.12.2024, së bashku me dokumentacionin e dorëzuar për konkursin përkatës; Aplikacionin e kandidatës F.H-R, të datës 12.11.2024, së bashku me dokumentacionin e dorëzuar për konkursin përkatës.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, **është e bazuar, sepse:**

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i provave të lëndës, ka gjetur se Komuna e Obiliqit, me datë 07.11.2024, ka shpallur konkursin me numër reference RN00015748, për pozitën e punës të klasës së ulët drejtuese: “*Drejtor i Qendrës për Punë Sociale*”, me afat aplikimi nga data 07.11.2024 deri më datë 07.12.2024.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë shtatë (7) kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesi, të cilit sipas Vendimit me numër protokolli 12-111-01-38074-24 të datës 11.12.2024, i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se ka bashkangjitur letërnjoftimit pa afat si dhe nuk ka bashkangjitur dëshminë mbi masën disiplinore.

Ndërsa prej tyre shtatë (7) kandidatëve kriteret e konkursit i ka plotësuar dhe ka hyrë në listë të ngushtë vetëm kandidatja F.H, e cila duke qenë se ka plotësuar kriteret përkatëse ka marrë pjesë në të gjitha fazat e vlerësimit profesional të kandidatëve, dhe si rrjedhojë sipas Njoftimit me numër protokolli 12-111-01-39062-24 të datës 23.12.2024, të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Obiliqit, e njëjta me gjithsejtë 85.2 pikë të arritura është shpallur kandidate fituese për pozitën e punës “*Drejtor i Qendrës për Punë Sociale*”.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon për shkelje ligjore dhe pa rregullsi gjatë zhvillimit të procedurës së rekrutimit, duke theksuar ndër të tjera se emërtimi i pozitës nuk është në pajtim me ligjin e pagave, komisioni i pranimit nuk i plotëson kërkesat ligjore dhe se i njëjti pretendon se pa të drejtë i është refuzuar aplikacioni.

Kolegji i Këshillit, në përmbushje të mandatit kushtetues dhe ligjor për sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, si dhe në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore ka analizuar ligjshmërinë e shpalljes së Konkursit me numër reference RN00015784, për pozitën e punës të klasës së ulët drejtuese: “*Drejtore e Qendrës për Punë Sociale*”, dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se, organi përkatës i punësimit, si kriter të përgjithshme formale, në konkursin përkatës të punës ka vendosur: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë e arsimit të nivelit të parë. Bachelor: Juridik, Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkenca Politike, Psikologji, Punë Sociale, Gjeografi, Administratë Publike; Përvoja e punës e kërkuar:* *Së paku 3 (tri) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Rrjedhimisht, referuar paragrafit 1 dhe 2 të Nenit 38 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: *1. Pozitat në shërbimin civil grupohen sipas kategorisë, klasës, kualifikimit dhe natyrës së pozitës. 2. Pozitat në shërbimin civil ndahen në këto kategori: 2.1. Kategoria e lartë drejtuese që përfshin: sekretaren/in e përgjithshëm, drejtoren/i në përgjithshëm në agjenci të pavarur dhe rregullatore, drejtoren/in ekzekutiv dhe zëvendësdrejtoren/in e një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme me to; 2.2. Kategoria e mesme drejtuese që përfshin pozitën e drejtores/it të departamentit dhe pozitat e barasvlershme me të; 2.3. Kategoria e ulët drejtuese që përfshin pozitën e udhëheqës/it të divizionit dhe pozitat e barasvlershme me të; 2.4. Kategoria e specialistëve që përfshin profesionistë në fusha që kërkojnë përgatitje specifike; dhe 2.5. Kategoria profesionale që përfshin zyrtarët profesional.; si dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, përkatësisht Nenit 1, ku përcaktohet se: *Kjo Rregullore përcakton klasat për secilën kategori të shërbimit civil, emërtesat e pozitave për çdo klasë, përshkrimin e përgjithshëm për secilën kategori dhe klasë, procedurën dhe metodologjinë e klasifikimit të pozitave të punës dhe ndarjen e grupeve të administrimit të përgjithshëm dhe administrimit të veçantë në shërbimin civil të Kosovës.; Nenit 4, ku përcaktohet se: 1. Pozitat e punës për nëpunësit e shërbimit civil ndahen në këto kategori: 1.1. kategoria e lartë drejtuese; 1.2. kategoria e mesme drejtuese; 1.3. kategoria e ulët drejtuese; 1.4. kategoria e specialistëve; 1.5. kategoria profesionale.; Nenit 12, ku përcaktohet se: *Klasat përbërëse të kategorisë së mesme drejtuese dhe emërtesat e lejuara për secilën klasë janë: Drejtues i Mesëm 1. Drejtore Departamenti në Zyrën e Kryeministrit; 2. Drejtore Departamenti në një Ministri; 3. Drejtore Departamenti në Agjenci të Pavarur; 4. Drejtore e Departamentit në Agjenci Rregullatore; 5. Drejtore e Departamentit në Agjenci Ekzekutive.; si dhe Nenit 13, ku përcaktohet se: *Klasat përbërëse të kategorisë së ulët drejtuese dhe emërtesat e lejuara për secilën klasë janë: Drejtues i Ulët 1. Udhëheqës i Divizionit në Zyrën e Kryeministrit; 2. Udhëheqës i Divizionit në një Ministri; 3. Udhëheqës i Divizionit në Agjenci të Pavarur; 4. Udhëheqës i Divizionit në Agjenci të Pavarur dhe në Agjenci Rregullatore; 5. Udhëheqës i Divizionit/Sektorit në Agjenci Ekzekutive dhe Komuna.****

Andaj, duke qenë se me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, emërtesa e lejuar për klasën e kategorisë së mesme drejtuese është Drejtor i Departamentit pranë Institucioneve Qëndrore, ndërsa emërtesa e lejuar për klasën e kategorisë së ulët drejtuese është Udhëheqës i Divizionit pranë Institucioneve Qëndrore dhe Komunale, dhe meqenëse nga provat e administruara të lëndës është vërtetuar se organi përkatës i punësimit, gjegjësisht Komuna e Obiliqit, në shpalljen e Konkursit me numër reference RN00015748, të datës 07.11.2024, për pozitën e lirë të kategorisë së ulët drejtuese ka vendosur emërtimin “*Drejtor i Qendrës për Punë Sociale*”, Kolegji i Këshillit konstaton se emërtimi i kësaj pozite është në kundërshtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ngase sipas këtij përcaktimi ligjor pozita më e lartë e Shërbimit Civil në kuadër të nivelit Komunal është ajo e Udhëheqësit të Divizionit, ndërsa përcaktimi i kërkesave të përgjithshme formale dhe po ashtu Koeficienti i pagës së përcaktuar për këtë pozitë pune në vlerën prej 7.18, sipas shtojcës Nr.10.7 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, përkon me atë Klasës Gj7, për pozitën e Drejtues i Ulët në Komuna që ka 10.001 deri 20.000 qytetar.

Duke qenë në rrethanat e rastit konkret dhe me qëllim të vendosjes në mënyre meritore, Këshilli ka kërkuar sqarime dhe nga Ministria e Punëve të Brendshme/ Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, se a ka parashtruar kërkesë Komuna e Obiliqit për ndryshimin e emërtimit me rastin e shpalljes së kësaj pozite, mirpëpo kjo e fundit përmes shkresës elektronike zyrtare ka theksuar se vazhdimisht pranojmë kërkesë nga institucionet për vendosje të titujve në SIMBNJ, mirëpo nga organi përkatës i punësimit nuk ka pranuar ndonjë kërkesë që me rastin e shpalljes së konkursit përkatës të ndryshoj emërtimin e kësaj pozite, dhe se po ashtu nga shkresat e lëndës vërtetohet se Njësia e Burimeve Njerzore e organit përkatës të punësimit, më datë 30.10.2024 ka parashtruar kërkesën me numër protokolli 12-110-03-33714-24, për shpalljen e konkursit përkatës me emërtim po të njëjtë të pozitës tek Kryetari i Komunës së Obiliqit, ndërsa ky i fundit përmes shkresës me numër protokolli 02-111-01.34572-24 të datës 05.11.2024, rezulton se ka miratuar kërkesën për fillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën “*Drejtor i Qendrës për Punë Sociale*”.

Andaj, bazuar në rrethanat dhe konstatimet e dhëna si në arsyetim të këtij vendimi, Kolegji i Këshillit konstaton se emërtimi i kësaj pozite pune ka bërë që procedura e rekrutimit të zhvillohet në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, dhe se për shkak të shkeljeve të evidentuara si më lartë kjo procedurë e rekrutimit konsiderohet e paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit me qëllim të kthimit të ligjshmërisë vendosi për aprovimin e ankesës si të bazuar, dhe anulimin e procedurës së rekrutimit, sikurse është përcaktuar në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.147/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit M.K;
- Kryetarit të Komunës dhe Udhëheqëses së Personelit në Komunën e Obiliqit; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.